

VENDIM
Nr. 214, datë 29.3.2006

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.30, DATË 28.1.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR KRITERET E ZGJEDHJES DHE RREGULLIMIN E MARRËDHËNIEVE TË SHOQËRIVE, QË
DO TË NDËRTOJNË DHE PËRDORIN INSTALIME BREGDETARE, PËR TRANSPORTIMIN DHE
DEPOZITIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.30, datë 28.1.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1.Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Për vlerësimin e kërkesave dhe të dokumentacionit të paraqitur nga shoqëritë, sipas përcaktimit të pikës 2 të vendimit, të ngrihet komisioni i vlerësimit të kërkesave, me këtë përbërje:

- | | |
|--|------------|
| - Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës | 4 anëtarë; |
| - Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit | 2 anëtarë; |
| - Ministria e Financave | 1 anëtar; |
| - Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave | 1 anëtar; |
| - Ministria e Brendshme | 1 anëtar; |
| - Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | 1 anëtar. |
- Kryetari i komisionit caktohet nga ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”.

2. Kudo në vendim emërtimet “Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit” dhe “Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë”, zëvendësohen me “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” emërtimet “Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit” dhe “Ministria e Transportit”, zëvendësohen me “Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit”, emërtimi “Ministria e Mjedisit”, zëvendësohet me “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave”.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha